

Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

KËTË JAVË:

- Skënder Hyseni t'i ndalë menjëherë deportimet nga Kosova
- Dhimbje për viktimat e Mynihut
- ZGJEDHET STRUKTURA E RE UDHËHEQËSE E LËVIZJES VETËVENDOSJE!

Skënder Hyseni t'i ndalë menjëherë deportimet nga Kosova

Javës që shkoi, aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!-s, z. realizuan një aksion simbolik ku kanë gjuajtur me ngjyrë veturën e tij.

Urdhrat që ndalojnë lirinë e lëvizjes, hyrjen dhe qëndrimin në Kosovë të qytetarëve nga Republika e Shqipërisë, janë urdhra me prapavijë politike dhe të padrejtë. Ministri i Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, duke urdhëruar dëbimin nga Kosova për aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! të cilët nuk kanë shkelur asnjë ligj po bën gabime të rënda politike. Policia dhe institucionet e rendit të drejtuara prej tij po shkelin të drejtat e liritë e njeriut, madje edhe ligjet e Kosovës duke përndjekur aktivistët e Lëvizjes me origjinë nga Shqipëria.



Ndalimin e hyrjes në Kosovë për Dejana Mihalini, e më herët deportimet e aktivistëve Boiken Abazi, Arbër Zaimi dhe ndalimin e hyrjes për Bashkim Rodonin, kjo qeveri po i bën në kohën kur strukturat kriminale të Serbisë enden të lirë nëpër Kosovë, madje me përcjellje të policisë.

Ne kërkojmë heqjen e menjëhershme të urdhrat të ndalimit për Dejana Mihalini, Bashkim Rodonin e Boiken Abazin, si dhe ndaljen e persekutimit të aktivistëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE! nga Republika e Shqipërisë. Përndryshe aksionet tona nuk do të ndalen me kaq!

Dhimbje për viktimat e Mynihut

Lëvizja VETËVENDOSJE! dhe aktivistët e saj dëshirojnë t'i shprehin ngushëllime familjarëve të viktimave të aktit të dhunshëm e kriminal që ndodhi dje në Mynih. Mes atyre që humbën jetën ishin edhe tre me origjinë shqiptare, e kjo e materializon dhimbjen tonë në një mënyrë edhe më tragjike.

I bashkohemi shpresës mbarënjerezore që ky lloj i dhunës që po e shoqëron njerëzimin në dy dekadat e fundit, të ndalet. Pasiguria e frika që janë synim i terrorit, mposhten vetëm përmes një solidariteti të hapur, jopërrjashtues, që nuk i diskriminon njerëzit mbi baza origjine e identiteti, e që nuk është indiferent ndaj problemeve të vogla a të mëdha të njeriut, të cilin ideologji të caktuara e kanë lënë të vetmuar.

Pra as braktisje me indiferencë në vetmi, as grumbullim identitar përjashtues. Zgjidhjen ne e shohim tek shtrirja e dorës së solidaritetit, dialogimit, bashkëpunimit, dhe pranimit të njerëzimit si një e tërë mozaikale që nuk qëndron nëse ia heq qoftë edhe njërin pjesë.

ZGJEDHET STRUKTURA E RE UDHËHEQËSE E LËVIZJES VETËVENDOSJE!

Më 24 korrik 2016 është mbajtur mbledhja e III-të zgjedhore e Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Kjo mbledhje ishte njëkohësisht edhe përmbyllje e procesit të brendshëm zgjedhor në Lëvizje.



Përgjatë këtyre tre muajve sa zgjati procesi zgjedhor kemi vërtetuar se

Nr. 472, 28 korrik 2016

demokracia e brendshme që sjellë rritje e zgjerim, është mënyra më e mirë për të forcuar strukturat e bashkuar njerëzit. Janë zgjedhur strukturat në mbi 300 Pika nëpër lagje e fshatra anekënd Kosovës që do ta bartin fjalën e Lëvizjes në popull, e porositë e qytetarëve në Lëvizje. Nga gjithsej 26 Qendra të Lëvizjes, 5 kryetare janë gra. Nga ky proces, Lëvizjes i janë bashkuar mbi 4000 anëtarë të rinj, ndërsa 2000 aktivistë janë ngarkuar me detyra konkrete të nivele të ndryshme organizative. Kjo është forca lëvizëse e VETËVENDOSJE-s në popull drejt ndryshimeve të pashmangshme që na presin. Ky proces zgjedhor ka rritur e forcuar kapacitetet organizative të Lëvizjes që janë kushti dhe mundësia për t'i realizuar qëllimet tona programore.

Me këtë organizim të ri, Lëvizja është e gatshme që t'i zhvillojë edhe më e fuqishme betejat e saj. Marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi nuk duhet të kalojë dhe strukturat e reja të organizatës sonë janë syçelë dhe të gatshme që të mos e lejojnë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje të dëmshme. Struktura udhëheqëse e Lëvizjes, e zgjedhur në këtë mbledhje:

Nënkryetar i Parë: Dardan Sejdiu

Nënkryetare e Dytë: Fatmire Mullhaxha Kollçaku

Sekretar Organizativ: Dardan Molliqaj

Sekretar për Marrëdhënie me Jashtë: Boiken Abazi

Koordinatorë për Komitete: Dejana Mihali

Kryesues i Këshillit të Përgjithshëm: Hydajet Hyseni

Zv. Kryesues i Këshillit të Përgjithshëm: Faruk Mujka

Anëtarë të tjerë të Kryesisë:

Albin Kurti, Shpend Ahmeti, Glauk Konjufca, Aida Dërguti, Elvis Hoxha, Dukagjin Gorani, Xhelal Sveçla, Albulena Haxhiu, Donika Kadaj Bujupi, Ylli Hoxha, Zgjim Hyseni, Sami Kurteshi, Liburn Aliu, Nazlie Bala, Belgzim Kamberi, Rexhep Selimi